

**Deklaratë për Shtyp**

**ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË  
PËR TREMUJORIN E DYTË TË VITIT 2009**

\_\_\_ Shtator 2009


Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e dytë të vitit 2009 rezultoi në rritje të mjeteve valutore me 142 milionë euro. Tremujori i dytë i vitit u mbyll me një deficit të llogarisë korente prej 360 milionë eurosh. Në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2008, deficitin u zvogëluar me rreth 3 milionë euro, nga 363 milionë euro. Deficiti i tregtisë së mallrave arriti në 567 milionë euro nga 561 milionë euro në tremujorin e dytë të vitit të kaluar. Flukset hyrëse të kapitalit regjistruan vlerën 434 milionë euro, duke tejkaluar dhe financuar plotësisht deficitin korent.

**I. LLOGARIA KORENTE**

Shuma e transaksioneve korente hyrëse dhe dalëse, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009, ishte 2,203 milionë euro ose rreth 7% më e ulët se një vit më parë. *Llogaria korente* regjistroi një deficit prej 360 milionë eurosh, krahasuar me 363 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në ngushtimin e deficitit kanë kontribuar rritja e suficitit të *transfertave korente* (nga 233 milionë euro në 237 milionë euro), si dhe ngushtimi i deficitit në kategorinë të *ardhura* (nga 17 milionë euro në 11 milionë

Llogaria Korente



Milionë euro



euro). Ndërkohë, deficitin në tregtinë e *mallrave* u rrit në 567 nga 561 milionë euro dhe deficitin në *shërbime* (prej 18 milionë eurosh) shënoi të njëjtin nivel të një viti më parë. Rreth 60% e shpenzimeve korente kanë shkuar për financimin e *importeve të mallrave*, ndërkohë që hyrjet valutore janë siguruar nga *eksportet e shërbimeve* dhe të *mallrave* (64%) dhe nga *transfertat korente* të njëanshme (30%).

## II. TREGTIA E MALLRAVE

Vëllimi i përgjithshëm i shkëmbimeve tregtare gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009 shënoi 957 milionë euro, me një rënie vjetore prej 12%. Shitblerja e mallrave përfaqësoi rreth 43% të veprimeve korente. *Eksportet* shënuan një rënie vjetore prej 25% dhe vlerësohen në 195 milionë euro. Ndërkohë që për *importet* u paguan 762 milionë euro ose 7% më pak se një vit më parë. *Deficiti tregtar* u thellua me rreth 6 milionë euro duke arritur në 567 milionë euro. Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet ra në nivelin 26% nga 32% në një vit më parë. Pagesat për importe janë rritur për grupet *makineri dhe pajisje* (22%) dhe *produkte farmaceutike* (18%). Ndërkohë, kanë rënë ndjeshëm importet e *lëndëve djegëse* (51%), duke dhënë kontributin kryesor në rënien e importeve kundrejt një viti më parë. Rënia vjetore e vlerës së importit të karburanteve me 50%, është shkaktuar kryesisht nga rënia e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare, ndonëse sasia e karburanteve të importuara gjatë këtij tremujori ishte gjithashtu, më e ulët sesa në tremujorin e dytë të vitit të kaluar (9%). Një rënie vjetore prej 10% është regjistruar në vlerën e importit të grupmallrave ushqimorë. Në krahun e eksporteve rënia vjetore me 25% gjatë kësaj periudhe erdhi si pasojë e drejtpërdrejtë e tkurrjes së eksportit nga prodhimi i brendshëm, kryesisht në kategorinë e metaleve dhe naftës së papërpunuar.




### III. ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE

*Llogaria e shërbimeve* u mbyll me një deficit prej 18 milionë eurosh. Ndaj tremujorit të dytë të vitit 2008 vërehet përmirësimi i pozicionit neto për kategorinë *shërbimet e udhëtimit*, nga deficiti prej 30 milionë eurosh në suficitin prej 3 milionë eurosh. Ndërkohë, janë tkurrur ndjeshëm *shërbimet e tjera*, bilanci pozitiv i të cilave u mbyll me 9 milionë euro nga 50 milionë euro në vitin 2008.

*Shërbimet e udhëtimit* zënë peshën më të madhe në të ardhurat dhe shpenzimet e shërbimeve, me përkatësisht 75% dhe 71% të totalit. Bilanci neto i shërbimeve të udhëtimit shënoi një suficit prej rreth 3 milionë eurosh. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, eksporti i shërbimeve të udhëtimit i ka siguruar ekonomisë vendase rreth 300 milionë euro ose 20% më shumë se sa në vitin 2008. Rritja e të ardhurave gjatë këtij tremujori është pasojë e rritjes së numrit të vizitorëve të huaj, si dhe rritjes së shpenzimeve mesatare ditore. Ndërkohë, rezidentët kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë vendit 297 milionë euro ose 6% më shumë se një vit më parë. Në këtë rritje ka ndikuar kryesisht rritja e shpenzimeve mesatare ditore, ndërkohë që numri i udhëtarëve shqiptarë jashtë vendit ka shënuar një rritje të lehtë (3%).


*Llogaria e të ardhurave* u mbyll me një bilanc negativ prej 11 milionë eurosh. Të hyrat në valutë të kësaj kategorie ranë rreth 15%, ndërsa daljet ranë me 20%. Dy burimet kryesore të të ardhurave kanë qenë puna e punëtorëve sezonalë dhe kufitarë dhe të ardhurat nga investimet në formën e interesave të depozitave të sistemit bankar, jashtë. Në anën e shpenzimeve, Shqipëria gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009 ka paguar 12 milionë euro për të shlyer interesat mbi borxhin e saj të jashtëm.

*Transfertat korente* neto u vlerësuan në 237 milionë euro, nga të cilat 198 milionë euro kanë hyrë në formën e *dërgesave të emigrantëve*. Këto të fundit shënuan një rënie vjetore prej rreth 4% nga vlera prej 207 milionë eurosh e një viti më parë. Njëkohësisht, vihet re rënie e transfertave dalëse të sektorëve të tjerë me rreth 27%.



#### IV. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009 Shqipëria regjistroi një prurje neto prej 434 milionë eurosh në *llogarinë kapitale dhe financiare*. Nga këto, rreth 16 milionë euro kanë hyrë në vend në formën e granteve për investime kapitale, ndërsa 417 milionë euro në formën e flukseve financiare neto. Flukset hyrëse të kapitalit kanë qenë plotësisht të mjaftueshme për financimin e deficitit korent prej 360 milionë eurosh. Llogaria financiare regjistroi rritje të detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj botës dhe rënie të mjeteve të rezidentëve jashtë. Në llogarinë financiare lëvizjet më të mëdha janë regjistruar në zërat e *investimeve të huaja direkte, huamarrjes dhe mjeteve të rezidentëve jashtë*. Hyrjet në formën e investimeve të huaja direkte në ekonominë shqiptare (313 milionë euro) ishin një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare të vendit.



Lëvrimet e kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë, gjatë këtij tremujori vlerësohen në 161 milionë euro. *Huamarrja për sektorin publik* (tërheqjet) ishte rreth 158 milionë euro ose 59 milionë më tepër se sa në vitin 2008. *Huamarrja private* shënoi një vlerë mjaft të ulët (3 millkonë euro) ndërkohë që për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ajo ishte rreth 28 milionë euro. Rritja e këtyre detyrimeve ka çuar në rritjen e detyrimeve për pagesat e ardhshme të borxhit të jashtëm. *Shërbimi i borxhit të jashtëm* për tremujorin e dytë të vitit 2009 ka pakësuar detyrimet e rezidentëve me 37 milionë euro.

Mjetet valutore të investuara jashtë ekonomisë shqiptare kanë regjistruar një rënie neto prej 132 milionë eurosh. Kjo rënie vihet re kryesisht në investimet në formën e *depozitave* të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente (126 milionë euro). Gjithashtu, në rënie janë paraqitur mjetet financiare në formën e *investimeve të portofolit* (15 milionë euro). *Mjetet e rezervës* u rritën me 142 milionë euro. *Stoku i rezervës valutore* në fund të tremujorit të dytë të vitit 2009 shënoi nivelin

1,711 milionë euro, i mjaftueshëm për mbulimin e 4.2 muaj importesh të mallrave dhe shërbimeve.

**Bilanci i pagesave (në milionë euro).**

	T1'08	T2'08	T3'08	T4'08	T1'09	T2'09
<b>Llogaria korente</b>	-267.3	-363.5	-230.7	-457.4	-323.3	-359.8
Eksporti i mallrave	206.5	260.4	242	208.6	176.1	195.0
Importi i mallrave	-733.9	-821.6	-844	-949.5	-692.5	-762.4
Bilanci tregtar	-527.3	-561.3	-602	-740.9	-516.4	-567.4
Shërbimet: kredi	351.9	397.9	517.7	420.2	302.8	397.5
Shërbimet: debi	-355.2	-415.8	-430.5	-416.8	-324.2	-415.9
Të ardhurat: kredi	75	66.7	97.2	77.8	63.6	56.4
Të ardhurat: debi	-54.5	-84.1	-42.3	-29.3	-67.9	-67.0
Transferta private pa shpërblim	236.9	226.8	217.9	223.7	216.6	225.9
Transferta shtetërore pa shpërblim	6.0	6.3	11.3	7.9	2.2	10.7
<b>Llogaria kapitale</b>	12.9	17.7	27.2	20.3	19.6	16.2
<b>Llogaria financiare</b>	154.2	354.7	180.8	764.8	256.9	417.5
Investime direkte	81.4	112	157.3	239.8	122.3	301.8
Investime portofoli	1	0.6	-11.7	-59.1	3.0	14.7
Kapitale të tjera*	74.7	241.8	36	586	133.0	102.8
<b>Gabime dhe harresa neto</b>	73.2	0.9	141.1	-237.2	-84.0	67.7
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	-27.0	9.9	118.5	90.5	-130.9	141.6
Mjetet e rezervës	27.0	-9.9	-118.5	-90.5	130.9	-141.6
Përdorim huash e kredish nga FMN	-2.9	0.3	-0.7	-1.8	-1.3	-1.8
Ndryshimi total në rezerva	-66.2	6.8	180.8	97.1	-101.0	116.2
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	-39.3	-3	62.3	6.6	29.8	-25.5

\* Nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.  
Burimi: Banka e Shqipërisë.

## **Shënime:**

### **Rishikimi i të dhënave**

Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në përputhje me politikat e rishikimit të informacionit statistikor të Bankës së Shqipërisë, statistikave të bilancit të pagesave i janë nënshtruar rishikimit për periudhën janar-mars të vitit 2009.

### **Informacion ndihmës për statistikave të bilancit të pagesave**

Të dhëna të plota dhe të përditësuara të bilancit të pagesave publikohen çdo tremujor në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, në drejtorinë "Statistika" /Seri Kohore/Statistika të Sektorit të Jashtëm /Bilanci i Pagesave.

Një material i detajuar mbi metodologjinë e përdorur për hartimin e statistikave të bilancit të pagesave gjendet në drejtorinë "Statistika", seksioni "Publikime për Statistikat", nën titullin *Metodika e Bilancit të Pagesave*.